

Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 7

Pasqyra e fluksit monetar

Objektiv

Informacioni rreth fluksit monetar të një njësie ekonomike është i dobishëm për të pajisur përdoruesit e pasqyrave financiare me një informacion bazë për të vlerësuar aftësinë e njësive ekonomike për të gjeneruar mjete monetare ose ekuivalentë të tyre dhe për të vlerësuar nevojat e njësive ekonomike për të përdorur këto flukse monetare. Vendimet ekonomike që merren nga përdoruesit kërkojnë një vlerësim të aftësisë së një njësie ekonomike për të prodhuar mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare, si dhe kohën dhe sigurinë e gjenerimit të tyre.

Qëllimi i këtij standardi është që të kërkojë ofrimin e informacionit rreth ndryshimeve historike të mjeteve monetare dhe të ekuivalentëve të mjeteve monetare nëpërmjet një pasqyre të fluksit monetar, e cila klasifikon fluksin e mjeteve monetare gjatë periudhës prej shfrytëzimit, investimit dhe veprimtarisë financiare.

Objekti

- Një njësi ekonomike përgatit një pasqyrë të fluksit monetar në përputhje me kërkesat e këtij Standardi dhe e prezanton atë si pjesë përbërëse të pasqyrave financiare të saj për secilën periudhë për të cilën paraqiten pasqyrat financiare.**
- Ky standard ka zëvendësuar SNK 7 *Pasqyra e Ndryshimeve në Pozicionin Financiar*, të miratuar në korrik 1977.
- Përdoruesit e pasqyrave financiare të një njësie ekonomike janë të interesuar për mënyrën sesi njësia ekonomike prodhon dhe përdor mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare. Kjo ndodh pavarësisht nga natyra e aktivitetit të njësive ekonomike dhe pavarësisht nëse mjetet monetare konsiderohen si produkt i njësive ekonomike, sic mund të jetë rasti i një institucioni financiar. Pavarësisht se sa të ndryshme janë aktivitetet e të ardhurave apo prodhimeve të njësive ekonomike atyre u nevojiten mjete monetare kryesisht për të njëjtat arsye. Atyre u nevojiten mjete monetare për të zhvilluar operacionet e tyre, për të paguar detyrimet dhe për t'ia kthyer mjetet monetare investitorëve. Si rezultat, ky standard ju kërkon të gjitha njësive ekonomike të dorëzojnë një pasqyrë të fluksit monetar.

Përfitimet e informacionit mbi fluksin monetar

- Kur Pasqyra e fluksit monetar përdoret në lidhje me pjesën tjetër të pasqyrave financiare, jep informacion që i lejon përdoruesit të vlerësojnë ndryshimet në aktivet neto të një njësie ekonomike, strukturën e saj financiare (duke përfshirë aftësinë e saj likuiduese dhe paguese), dhe aftësinë e saj për të pasur ndikim mbi shumat dhe kohën e fluksit të mjeteve monetare, në mënyrë që të përshtatet me ndryshimin e rrethanave dhe mundësisë. Informacioni rreth fluksit monetar të një njësie ekonomike është i dobishëm vlerësimin e aftësisë të njësive ekonomike të gjenerojë mjete monetare ose ekuivalentë të tyre dhe i bën të aftë përdoruesit për të zhvilluar modele për të vlerësuar dhe krahasuar vlerën aktuale të flukseve monetare të ardhshme të njësive ekonomike të ndryshme. Ai rrit dhe krahasueshmërinë e raportimit të performancës së operimit nga njësi të ndryshme ekonomike pasi bën të mundur eliminimin e efekteve të përdorimit të trajtimeve të ndryshme kontalël për të njëjtat transaksione ose ngjarje.
- Informacioni historik i fluksit monetar shpesh përdoret si një tregues i shumës, i kohës dhe i sigurisë për flukse mjeteve monetare të ardhshme. Ai shërben gjithashtu për të kontrolluar saktësinë e vlerësimeve të mëparshme të flukseve të mjeteve monetare të ardhshme dhe për të shqyrtuar marrëdhënien ndërmjet probabilitetit dhe fluksit neto të mjeteve monetare dhe ndikimit të ndryshimit të cmimeve.

Përkufizime

- Termat e mëposhtëm të përdorur në këtë Standard kanë këtë kuptim:**
***Mjetet monetare* përfshijnë mjetet monetare në arkë dhe depozitat me afat**

Ekuivalentët e mjeteve monetare janë investime afatshkurtra, shumë likuide dhe të gatshme për t'u konvertuar në shuma të njohura të mjeteve monetare dhe të cilat janë objekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë.

Flukset monetare janë hyrjet ose daljet e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare.

Veprimtari të shfrytëzimit janë aktivitetet bazë të prodhimit të të ardhurave të njësisë ekonomike dhe aktivitetet të tjera të cilat nuk janë aktivitetet investuese ose financuese

Veprimtari investuese janë blerja, dhe nxjerrja e aktiveve afatgjata dhe investime të tjera që nuk përfshihen në ekuivalentët e mjeteve monetare.

Aktivitetet financuese janë aktivitetet që cojnë në ndryshime në masën dhe përbërjen e kapitalit neto të kontribuar dhe të huasë të njësisë ekonomike.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare

- 7 Ekuivalentët e mjeteve monetare mbahen me shumë për të plotësuar nevoja afatshkurtra për mjete monetare sesa për investim ose qëllime të tjera. Në mënyrë që një investim të cilësohet si një ekuivalent mjeti monetar, ai duhet të jetë i menjëherë i konvertueshëm në një shumë të njohur mjeteve monetare dhe të jetë subjekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë. Si rezultat, një investim cilësohet normalisht si një ekuivalent i mjeteve monetare vetëm kur ai ka një maturim të shkurtër, le të themi prej tre ose më pak muajsh nga data e blerjes. Investimet në kapital neto përjashtohen nga ekuivalentët e mjeteve monetare, përveçse kur ato në thelb janë ekuivalentë të mjeteve monetare, për shembull rasti i aksioneve preferencialë të blera brenda një periudhe të shkurtër maturimi dhe me një datë të specifikuar riblerjeje.
- 8 Huamarrja bankare zakonisht konsiderohet si veprimtari financiare. Gjithsesi, në disa vende llogaritë bankare të zbuluara të janë të ripagueshme menjëherë me paraqitjen e kërkesës, formojnë një pjesë pjesë përbërëe e menaxhimit të mjeteve monetare të një njësie ekonomike. Në këto kushte, llogaritë bankare të zbuluara përfshihen në përbërje të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të mjeteve monetare. Një karakteristikë e këtyre rregullimeve bankare është fakti se teprica e llogarisë bankare shpesh ndryshon nga një tepricë pozitive në një tepricë negative.
- 9 Fluxet monetare përjashtojnë lëvizjet ndërmjet elementeve që përbëjnë mjete monetare ose ekuivalentë të mjeteve monetare pasi këto komponentë janë më shumë pjesë e menaxhimit të mjeteve monetare të një njësie ekonomike sesa pjesë të aktiviteteve shfrytëzuese, investuese ose financuese. Menaxhimi i mjeteve monetare përfshin investimin e mjeteve të tepërta monetare në ekuivalentë të mjeteve monetare.

Paraqitja e pasqyrës së fluksit monetar

- 10 **Pasqyra e fluksit monetare raporton fluksin e mjeteve monetare gjatë periudhës duke e klasifikuar nga aktivitetet shfrytëzuese, investuese dhe financuese.**
- 11 Një njësi ekonomike paraqet fluksin e mjeteve të saj monetare nga aktivitetet shfrytëzuese, investuese dhe financuese në mënyrë që është më e përshtatshme për biznesin e saj. Klasifikimi nëpërmjet aktiviteteve ofron informacion që u lejon përdoruesve të vlerësojnë ndikimin e atyre aktiviteteve mbi pozicionin financiar të njësisë ekonomike dhe shumën e mjeteve të saj monetare dhe ekuivalentëve të mjeteve monetare. Ky informacion mund të përdoret edhe për të vlerësuar marrëdhëniet ndërmjet këtyre aktiviteteve.
- 12 Një transaksion i vetëm mund të përfshijë flukse të mjeteve monetare që janë të klasifikuara ndryshe. Për shembull, kur ripagimi i mjeteve monetare të një huaje përfshin si interesin dhe kapitalin, elementi i interesit mund të klasifikohet si një aktivitet operativ dhe elementi i kapitalit mund të klasifikohet si aktivitet financues.

Veprimtari të shfrytëzimit

- 13 Shuma e fluksit të mjeteve monetare që krijohet nga veprimtaritë të shfrytëzimit është një element kyç për të vlerësuar shkallën në të cilën veprimtaria e njësisë ekonomike ka prodhuar flukse të mjaftueshme mjeteve monetare për të ripaguar huatë, për të mbajtur kapacitetin e shfrytëzimit të njësisë ekonomike, për të paguar dividendët dhe për të bërë investime të reja pa përdorur burime të jashtme financimi. Informacioni rreth komponentëve specifikë të historisë të flukseve të mjeteve monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit është i dobishëm, i marrë së bashku me informacionet e tjera, për të parashikuar fluxet monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit në të ardhmen.
- 14 Fluxet e mjeteve monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit kryesisht rrjedhin nga veprimtaritë që prodhojnë të ardhura (të ardhura-prodhuese) të njësisë ekonomike. Si rezultat, ato përgjithësisht rrjedhin nga transaksionet

dhe ngjarjet e tjera që hyjnë në përcaktimin e fitimit ose humbjes. Shembuj të flukseve të mjeteve monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit janë:

- (a) mjetet monetare të marra nga shitja e mallrave dhe ofrimi i shërbimeve;
- (b) mjetet monetare të marra nga pagesat për përdorimin e pronës, tarifa, komisione dhe të ardhura të tjera;
- (c) Pagesa në mjete monetare të furnizuesve të mallrave ose shërbimeve;
- (d) Pagesa të mjeteve monetare për dhe në emër të punonjësve;
- (e) Mjetete monetare të marra dhe pagesa në mjete monetare të bërë një njësie ekonomike siguroese, për primet dhe kërkesat shtesë, anuitetet dhe për policia të tjera përfitimesh
- (f) Pagesa në mjete monetare ose rikthimi i tatimeve mbi të ardhurat, në përjashtim të rasteve kur ato identifikohen specifikisht me veprimtari investuese dhe financuese; dhe
- (g) Mjetet monetare të para dhe pagesat nga kontratat e realizuara për qëllime ndërmjetësimi ose tregëtimi.

Transaksione të tilla, si për shembull shitja e një elementi të caktuar të një impianti mund të cojnë në fitime ose humbje që përfshihet në përcaktimin e fitimit ose humbjes. Gjithsesi, flukset e mjeteve monetare që lidhen me transaksione të tilla janë flukse të mjeteve monetare nga veprimtaritë investuese.

- 15 Një njësi ekonomike mund të zotërojë letra me vlerë dhe hua për qëllime ndërmjetësimi ose tregëtimi, dhe në këto raste ato janë të ngjashme me inventarin blerë specifikisht për rishitje. Si rezultat, fluksi i mjeteve monetare që krijohen nga blerja dhe shitja e ndërmjetësimi ose tregëtimit të letrave me vlerë klasifikohet si veprimtari shfrytëzimi. Në mënyrë të ngjashme parapagimet e mjeteve monetare dhe huatë e dhëna nga institucionet financiare zakonisht klasifikohen si veprimtari shfrytëzimi përderisa ato lidhen me veprimtarinë kryesore të prodhimit të të ardhurave të asaj njësie ekonomike.

Veprimtari investuese

- 16 Dhënia e informacioneve të vecanta shpjeguese të flukseve të mjeteve monetare që realizohen nga veprimtaritë investuese është e rëndësishme pasi flukset e mjeteve monetare përfaqësojnë shkallën në të cilën janë kryer shpenzimet për burimet që do të përdoren për prodhimin e të ardhura dhe flukseve të mjeteve monetare në të ardhmen. Shembuj të flukseve monetare që krijohen nga veprimtaritë e shfrytëzimit janë:
- (a) Pagesat në mjete monetare për të blerë prona, ndërtesa, makineri e pajisje, aktive të afatgjata jo materiale dhe aktive të tjera afatgjata; Këto pagesa përfshijnë pagesat e lidhura me kostot e kapitalizuara të zhvillimit dhe pronat, makineri e pajisje të ndërtuara vetë;
 - (b) Mjetet monetare të marra nga shitja e pronave, makineri e pajisje, aktive të afatgjata jo materiale dhe aktive të tjera afatgjata;
 - (c) Pagesa në mjete monetare për të blerë instrumenta të kapitalit neto ose të borxhit të njërive të tjera ekonomike, dhe pjesëmarrjet në sipërmarrjet e përbashkëta (të ndryshëm nga pagesat e atyre instrumentave që konsiderohen si ekuivalentë të mjeteve monetare ose nga ato që mbahen për qëllimi ndërmjetësimi ose tregëtimi);
 - (d) Mjete monetare të marra nga shitja e instrumentave të kapitalit neto ose të borxhit të njërive të tjera ekonomike, dhe të pjesëmarrjeve në sipërmarrjet e përbashkëta (të ndryshëm nga arkëtimet e atyre instrumentave që konsiderohen si ekuivalentë të mjeteve monetare ose nga ato që mbahen për qëllimi ndërmjetësimi ose tregëtimi);
 - (e) Parapagime të mjeteve monetare dhe huatë e dhëna palëve të tjera (të ndryshme nga parapagimet dhe huatë e dhëna nga një institucion financiar;
 - (f) Mjete monetare të marra nga ripagimi i parapagesave dhe huave të dhënave palëve të tjera (të ndryshme nga parapagimet dhe huatë e dhëna nga institucioni financiar;
 - (g) Pagesat në mjete financiare për kontrata e të ardhmes, kontratat forward, kontratat opsjon dhe kontratat e këmbimit, me përjashtim të rasteve kur kontratat bëhen për qëllime ndërmjetësimi ose tregëtimi, ose ku pagesat klasifikohen si veprimtari financiar; dhe
 - (h) Mjetet monetare të marra nga kontratat e së ardhmes, nga kontratat forward, nga kontratat opsjon dhe kontratat e këmbimit, me përjashtim të rasteve kur kontratat bëhen për qëllime ndërmjetësimi ose tregëtimi, ose ku arkëtimet klasifikohen si veprimtari financiar;

Kur një kontratë llogaritet si një mbrojtje e një pozicioni të identifikuar, flukset monetare të Kontratës klasifikohen në të njëjtën mënyrë si fluksi monetar i pozicionit të të qënit i mbrojtur.

Veprimtari financiare

- 17 Dhënia e informacioneve të vecanta shpjeguese për flukset monetare që krijohen nga veprimtaritë financiare është e rëndësishme pasi ato shërbejnë për parashikimin e kërkesave për fluksin monetar të ardhshëm nga ofruesit e kapitalit për njësinë ekonomike. Shembuj të flukseve monetare që krijohen nga veprimtaritë e financimit janë:
- (a) Shuma në mjete monetare të marra nga emetimi i aksioneve ose instrumentave të tjerë të kapitalit neto;
 - (b) Pagesat në mjete monetare të bëra pronarëve të njësisë ekonomike për të blerë ose rimarrë aksionet e një njësie ekonomike;
 - (c) Shumat në mjete monetare nga emetimi i borxheve, huave, dëftesave premtuese, obligacioneve, huave hipotekare dhe huamarrjeve të tjera afatgjata ose aftashkurtëra;
 - (d) Ripagesat e mjeteve monetare për shumat e marra hua; dhe;
 - (e) Pagesa në mjete monetare nga një qiramarrës për uljen e pasivit të mbetur të lidhur me një qira financiare.

Raportimi i flukseve monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit

- 18 **Një njësi ekonomike raporton flukset monetare të veprimtarive të shfrytëzimit duke përdorur ose**
- (a) **Metodën e drejtpërdrejtë, nëpërmjet së cilës jepet informacion për klasat kryesore të mjeteve monetare të marra bruto dhe pagesat e mjeteve monetare bruto; ose**
 - (b) **Metodën e tërthortë, nëpërmjet së cilës fitimi ose humbja korrigjohet me efektet e transaksioneve që nuk kanë natyrë monetare, me shtyrjet ose rritjet e të kaluarës ose në të ardhmen e mjeteve monetare të marra ose të paguara, dhe me elementë të të ardhurave dhe shpenzimeve të lidhura me investimin ose financimin e fluksit të mjeteve monetare;**
- 19 Njësitë ekonomike inkurajohen të raportojnë flukset monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit duke përdorur metodën e drejtpërdrejtë. Metoda e drejtpërdrejtë jep informacion që mund të jetë i dobishëm në vlerësimin e flukseve monetare në të ardhmen dhe që i cili është i disponueshëm, nuk sigurohet me metodën e tërthortë. Nëpërmjet metodës së drejtpërdrejtë, informacioni rreth klasave kryesore të mjeteve monetare të marra bruto dhe pagesave bruto të mjeteve monetare mund të merret ose;
- (a) Nga regjistrimet kontabël të njësisë ekonomike; ose
 - (b) duke rregulluar shitjet, koston shitjeve (interesat dhe të ardhura dhe shpenzime të tjera të ngjashme, dhe tarifa të tjera të ngjashme për një institucion financiar) dhe zëra të tjera të pasqyrës së të ardhurave me
 - (i) Ndryshimet gjatë periudhës në inventarët, në llogaritë e arkëtueshme dhe llogari të pagueshme të aktivitetit operativ
 - (ii) Elementë të tjerë jo-mjete monetare dhe
 - (iii) Zëra të tjerë për të cilat efektet e mjeteve monetare janë flukse monetare investimi ose financimi.
- 20 Sipas metodën së tërthortë, fluksi neto monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit përcaktohet duke rregulluar fitimin ose humbjen me efektet e:
- (a) Ndryshimeve gjatë periudhës në inventarët, në llogaritë e arkëtueshme dhe llogari të pagueshme të aktivitetit operativ;
 - (b) Elementëve jo-mjete monetare si për shembull amortizimi, tatimet e shtyra, fitime dhe humbje neto të parealizuara nga monedhat e huaja, fitimet e pashpërndara të pjesmarrjeve dhe interesat të pakicës; dhe
 - (c) Të gjithë zërat e tjerë për të cilat efektet e mjeteve monetare flukse monetare investimi ose financimi.
- Ndryshe, fluksi monetar neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit mund të paraqitet sipas metodës së tërthortë duke treguar të ardhurat dhe shpenzimet të paraqitura në pasqyrën e të ardhurave dhe ndryshimet gjatë periudhës në inventarë, në llogari të arkëtueshme dhe llogari të pagueshme.

Raportimi i flukseve monetare nga veprimtaritë investuese dhe financuese

- 21 Një njësi ekonomike raporton vecmas klasat e mëdha të faturave të mjeteve monetare bruto dhe pagesat bruto të mjeteve monetare që rezultojnë nga veprimtaritë investuese dhe financuese, me përjashtim të rasteve të flukseve monetare të përshkruara në paragrafin 22 dhe 24, që raportohen mbi baza neto.

Raportimi i flukseve monetare mbi baza neto

- 22 **Flukset monetare që rrjedhin nga veprimtaritë e mëposhtëme të shfrytëzimit, investimit dhe financimit mund të raportohen mbi një bazë neto:**
- (a) Mjetet monetare të marra e të paguara në emër të klientëve kur flukset monetare reflektojnë më shumë aktivitetet e klientit sesa ato të njësisë ekonomike: dhe
 - (b) Mjete monetare të marra dhe të paguara për elementë që kanë qarkullim të shpejtë, elementë që kanë shuma të mëdha dhe elementë me maturime të shkurtra.
- 23 Shembuj të mjeteve monetare të marra dhe të paguara të cilave u referohet paragrafi 22(a) janë:
- (a) Pranimi dhe ripagimi i depozitave pa afat të një banke,
 - (b) Fondet e mbajtura për klientët nga një njësi ekonomike investimi; dhe
 - (c) Qiratë e mbledhura në emër të pronarëve të pronave dhe që u paguhen atyre
- Shembuj të mjeteve monetare të marra dhe të paguara të cilave u referohet paragrafi 22(b) janë parapagime të bëra për dhe ripagimi i:
- (a) Shumave principale të lidhura me klientët me kartë krediti;
 - (b) the purchase and Shitje of investments; dhe
 - (c) Hua të tjera afatshkurtra, për shembull ato hua që kanë një periudhë maturimi prej tre ose më pak muajsh
- 24 **Flukset monetare që rezultojnë nga secila nga veprimtaritë e mëposhtëme të një institucioni financiar mund të raportohen mbi një bazë neto:**
- (a) Mjete monetare të marra dhe të paguara për pranim dhe ripagim të depozitave me një datë fikse maturimi;
 - (b) Vendosja e depozitave në institucionet e tjera financiare dhe tërheqja e depozitave nga institucionet e tjera financiare dhe
 - (c) Parapagime të mjeteve monetare dhe huave të dhëna klientëve dhe ripagim i këtyre parapagesave dhe huave

Flukse monetare në monedhë të huaj

- 25 **Fluksi monetar që krijohet nga transaksionet në një monedhë të huaj do të regjistrohet në monedhën funksionale të njësisë ekonomike duke aplikuar në shumën e monedhës së huaj kursin e këmbimit ndërmjet monedhës funksionale dhe monedhës së huaj në datën e fluksit monetar**
- 26 **Flukset monetare të një filiali të huaj do të përkthehen me kurset e këmbimit ndërmjet monedhës funksionale dhe monedhës së huaj në datat e flukseve monetare**
- 27 Flukset monetare të shprehura në monedhë të huaj raportohen në një mënyrë që përkon me SNK 21 *Efektet e ndryshimit në kurset e këmbimit*: Kjo lejon përdorimin e një kursi këmbimi që përafrohet kursin aktual. Për shembull, mesatarja e ponderuar e kursit të këmbimit për një periudhë mund të përdoret për regjistrimin e transaksioneve në monedhë të huaj ose në përkthim të flukseve monetare të një filiali të huaj. Gjithsesi, SKN 21 nuk lejon përdorimin e kursit të këmbimit në datën e bilancit kur përkthehen flukset e mjeteve monetare të një filiali të huaj.
- 28 Fitimet dhe humbjet neto të përealizuara që rezultojnë nga ndryshimet në kursin e këmbimit në monedhë të huaj nuk janë flukse monetare. Gjithsesi, efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit mbi mjetet monetare dhe ekuivalentët të mjeteve monetare të cilat janë ose duhet të jenë në monedhë të huaj raportohen në pasqyrën e fluksit monetar në mënyrë që të rakordohen mjetet monetare dhe ekuivalentët të mjeteve monetare në fillim dhe në fund të periudhës. Kjo shumë paraqitet vecmas nga flukset monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit, të investimit dhe financimit dhe përfshin ndryshimet, nëse ka, kur këto flukse janë raportuar me kursin e këmbimit të fundit të periudhës.

- 29 [Fshirë]
30 [Fshirë]

Interes and Dividentët

- 31 **Flukset monetare nga marrja ose pagimi i interesit dhe dividentëve duhet të raportohen vecmas. Secili do të klasifikohet në mënyrë të qëndrueshme nga njëra periudhë në tjetrën ose si veprimtari shfrytëzuese, investuese ose financuese.**
- 32 Shuma totale e interesit të paguar gjatë një periudhe jepet në pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare nëse ajo është njohur si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave ose është kapitalizuar në përputhje me trajtimin alternativ të lejuar në SNK 23 *Kostot e huamarrjes*.
- 33 Interesi i paguar dhe interesi dhe dividentët e marrë zakonisht klasifikohen si flukse monetare operative për një institucion financiar. Gjithsesi, nuk ka konsensus për klasifikimin e këtyre flukseve monetare për njësi të tjera ekonomike. Interesi i paguar dhe interesi dhe dividentët e marrë mund të klasifikohen si flukse monetare operative pasi ata janë pjesë e përcaktimit të fitimit ose humbjes. Nga ana tjetër, interesi i paguar dhe interesi dhe dividentët e marrë mund të klasifikohen si flukse monetare të aktivitetit financues dhe flukse monetare të aktivitetit investues, pasi ata janë kosto të marrjes së burimeve financiare ose kthime të investimeve
- 34 Dividentët e paguar mund të klasifikohen si një fluks monetar i aktivitetit financues pasi ato përfaqësojnë një kosto të marrjes së burimeve financiare. Nga ana tjetër, dividentët e paguar mund të klasifikohen si komponentë të flukseve monetare nga veprimtari të shfrytëzimit në mënyrë që të ndihmohet përdoruesi të përcaktojë aftësinë e një njësie ekonomike për të paguar dividentë nga flukset monetare të aktivitetit të shfrytëzimit.

Tatimet mbi te ardhurat

- 35 **Flukset monetare që rezultojnë nga tatimet mbi të ardhurat do të paraqiten vecmas dhe do të klasifikohen si fluks monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit, me përjashtim të rasteve kur ato identifikohen me veprimtaritë financuese dhe investuese**
- 36 Tatimi mbi të ardhurat rezulton nga transaksionet të cilat cojnë në rezultimin e flukseve monetare që klasifikohen në një pasqyrë të flukseve monetare si veprimtari e shfrytëzimit, si aktivitet investues ose financues. Ndërsa shpenzimet e tatimeve mund të jenë lehtësisht të identifikueshme për veprimtari investimi dhe financiare, flukset monetare përkatëse të tatimit shpesh janë të pa identifikueshme dhe mund të krijohen në një periudhë të ndryshme nga flukset e mjeteve monetare të transaksionit në fjalë. Si rezultat, tatimet e paguara shpesh klasifikohen si flukse të mjeteve monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit. Gjithsesi, kur është e mundur të identifikohet fluksi i mjeteve monetare të tatimit me një transaksion individual që con në flukse të mjeteve monetare që klasifikohen si veprimtari investuese ose financiare, fluksi i mjeteve financiare të tatimit klasifikohet, në varësi të rastit, si veprimtari investimi ose financiare. Kur flukset e mjeteve monetare të tatimeve janë ndarë për më shumë se një klasë aktiviteti, jepet informacion shpjegues për të gjithë shumën e tatimit të paguar.

Investimet e filialeve, pjesëmarrje dhe sipërmarrjeve të përbashkëta

- 37 Kur kontabiliteti për një investim në një pjesëmarrje ose filial mbahet sipas metodës së të kapitalit neto ose metodës së kostos, një investues e kufizon raportimin në pasqyrën e fluksit monetar, në flukset monetare ndërmjet tij dhe investuesit, për shembull, të dividentëve dhe parapagesave.
- 38 Një njësi ekonomike që raporton interesin e saj në një njësi ekonomike të kontrolluar bashkërisht (shih SNK 31: *Pjesëmarrje në sipërmarrjet e përbashkëta*) duke përdorur konsolidimin proporcional, në pasqyrën e saj të konsoliduar të fluksit monetar përfshin pjesën e saj proporcionale të flukseve monetare të njësisë ekonomike të kontrolluar bashkërisht. Një njësi ekonomike që raporton një interes të tillë duke përdorur metodën e kapitalit neto përfshin në pasqyrën fluksit monetar të saj fluksin e mjeteve monetare që lidhet me investimet të saj në njësinë ekonomike të kontrolluar bashkërisht, dhe shpërndarjen dhe cdo pagese ose arkëtim tjetër ndërmjet saj dhe njësisë ekonomike të kontrolluar bashkërisht.

Blerjet dhe nxjerrja jashtë përdorimi e filialeve ose njësitë e tjera të biznesit

- 39 **Totali i flukseve monetare që rezultojnë nga blerjet dhe nxjerrja jashtë përdorimi e filialeve ose njësitë të tjera të biznesit do të paraqitet vecmas dhe do të klasifikohet si veprimtari investuese.**

- 40 Një njësi ekonomike do të japë informacion shpjegues, në total, përsa i përket blerjeve dhe nxjerrjes jashtë përdorimi të filialeve apo njërive të tjera të biznesit gjatë periudhës për sa vijon:
- (a) Shumës totale të blerjes së përgjithshme ose të nxjerrjes jashtë përdorimit;
 - (b) Pjesën e shumës të blerjes ose të marrë nga nxjerrja jashtë përdorimit të realizuar me mjete monetare dhe ekuivalentëve të mjeteve monetare;
 - (c) Shumës së mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të mjeteve monetare në filial ose njësi biznesi të blera ose të dala jashtë përdorimi; dhe
 - (d) Shumës së aktiveve dhe detyrimeve që nuk janë mjete monetare ose ekuivalentë të mjeteve monetare në një filial ose njësi biznesi të blerë ose të dalë jashtë përdorimi, të përmbledhur në bazë të kategorive kryesore;
- 41 Paraqitja vecmas e fluksit monetar nga efektet e blerjes dhe nxjerrjes jashtë përdorimi e filialeve dhe njërive të tjera të biznesit si elementë të një zëri të vetëm, së bashku me informacionin specifik për aktivet dhe pasivet e blera ose të nxjerra jashtë përdorimi ndihmon në dallimin e atyre flukseve monetare që vijnë nga flukset monetare që rezultojnë nga veprimtaritë e tjera operative, investuese dhe financuese. Efektet e flukseve monetare të nxjerrjeve jashtë përdorimit nuk zbriten nga flukset monetare të blerjes.
- 42 Shuma totale e mjeteve monetare të paguara ose të marra si blerje ose shitje raportohet në pasqyrën e fluksit monetar, pasi zbriten mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare të blera ose të nxjerra jashtë përdorimi.

Transaksione jo në vlera monetare

- 43 Transaksionet investuese dhe të financimit që nuk kërkojnë përdorimin e mjeteve monetare ose të ekuivalentëve të mjeteve monetare do të përjashtohen nga pasqyra e fluksit monetar. Këto transaksione do të shpjegohen gjetkë në pasqyrat financiare në një mënyrë që siguron të gjithë informacionin përkatës për këto veprimtari investimi dhe financimi.
- 44 Mjaft aktivitete investuese dhe financuese nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në flukset aktuale monetare megjithëse ato kanë ndikim mbi kapitalin dhe strukturën e aktiveve të një njësie ekonomike. Përjashtimi i transaksioneve jo në vlera monetare nga pasqyra e fluksit monetar është në përputhje me objektivin e pasqyrës së fluksit monetar pasi këto elementë nuk përfshijnë fluksin e mjeteve monetare në periudhën aktuale. Shembuj të transaksioneve jo në vlera monetare janë:
- (a) Blerja e aktiveve ose duke marrë përsipër detyrimet përkatëse në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet një qiraje financiare;
 - (b) Blerja e një njësie ekonomike nëpërmjet emetimit të kapitalit neto; dhe
 - (c) Shnëdrimi i borxhit në kapital neto

Komponentët e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të mjeteve monetare

- 45 Një njësi ekonomike jep informacion shpjegues rreth komponentëve të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të mjeteve monetare dhe paraqet një rakordim të shumave në pasqyrën e fluksit monetar me elementët ekuivalentë të raportuar në bilanc.
- 46 Duke pasur parasysh shumëllojshmërinë e praktikave të menaxhimit të mjeteve monetare dhe rregullimet bankare në mbarë botën dhe në mënyrë që të përputhet me SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare* një njësi ekonomike jep shpjegime për politikën që ajo përdor në përcaktimin e përbërjes së mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të mjeteve monetare.
- 47 Efektet e cdo ndryshimi në politikën e përcaktimit të komponentëve të mjeteve monetare dhe të ekuivalentëve të mjeteve monetare, për shembull një ndryshim në klasifikimin e instrumentave financiare që më parë konsideroheshin pjesë e portofolit të investimeve të njësisë ekonomike raportohet në përputhje me SNK 8: *Politikat kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*.

Shpjegime të tjera

- 48 Një njësi ekonomike do të japë informacion shpjegues së bashku me një komentari të menaxhimit për shumën e rëndësishme të tepërave të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të mjeteve monetare të njësisë ekonomike që nuk janë të disponueshme për përdorim nga grupi.

- 49 Ka rrethana të ndryshme në të cilat tepricat e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të mjeteve monetare të zotëruara nga një njësi ekonomike nuk janë të disponueshme për përdorim nga grupi. Shembujt që mund të jepen përfshijnë tepricat e mjeteve monetare dhe të ekuivalentëve të mjeteve monetare të një filiali që operon në vendin në të cilin aplikohen kontrollet e këmbimit ose kufizime të tjera ligjore kur gjendet nuk janë të disponueshme për përdorim të përgjithëm nga shoqëria mëmë ose filialet e tjera.
- 50 Informacion shtesë mund të jetë i rëndësishëm për përdoruesit për të kuptuar pozicionin financiar dhe likuiditetin e një njësie ekonomike. Inkurajohet dhënia e këtij informacioni si dhe një komentuar nga menaxhimi, dhe që mund të përfshijë:
- (a) Shumën e huasë së patërhequr që mund të jetë e disponueshme për veprimtari të shfrytëzimit të në ardhmen dhe për të përcaktuar kapitalin, duke dhënë kufizimet në përdorimin e tyre;
 - (b) Shumën totale të fluksit monetar nga secila nga veprimtaritë shfrytëzuese, investuese dhe financuese të lidhur me pjesëmarrje në sipërmarrjet e përbashkëta të raportuara duke përdorur konsolidimin proporcional;
 - (c) Shumën totale të flukseve monetare që përfaqëson rritje në kapacitetin shfrytëzues vecmas nga flukset e mjeteve monetare që kërkohen për mirëmbajtjen e kapacitetit të shfrytëzimit; dhe
 - (d) Shumën e flukseve monetare që dalin nga veprimtaritë shfrytëzuese, investuese dhe financuese të secilit segment raportimi (Shih SNRF 8: *Segmente të shfrytëzimit*).
- 51 Informacion shpjegues i vecantë për flukset monetare që përfaqësojnë rritje në kapacitetin shfrytëzues dhe për flukset monetare që kërkohen për të mirëmbajtur kapacitetin shfrytëzues është i dobishëm për të mundësuar që përdoruesit të përcaktojnë nëse njësi ekonomike po investon ashtu sic duhet në mirëmbajtjen e kapacitetit të saj shfrytëzues. Një njësi ekonomike që nuk investon mirë në mirëmbajtjen e kapacitetit të saj shfrytëzues mund të paragjykojë probabilitetin për të ardhmen për shkak të ikuiditetit aktual dhe shpërndarjeve tek pronarët.
- 52 Informacioni shpjegues i flukseve monetare u bën të mundur përdoruesve që të kenë një kuptim më të mirë të marrëdhënies ndërmjet flukseve monetare të biznesit si një i tërë me pjesët e tij përbërëse si dhe të disponueshmërinë dhe ndryshueshmërinë të flukseve segmentale të mjeteve monetare.

Data e hyrjes në fuqi

- 53 Ky Standard hyn në fuqi për pasqyrat financiare që mbulojnë periudhat që filliojnë në ose mbas datës 1 janar 1994 e në vazhdim.